

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7184
E mërkurë, 15 maj 2024
Çmimi 0.50 €

Blinkeni u thotë ukrainasve se ndihma ushtarake "është rrugës"

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI SHPREH GATISHMËRI ME OPOZITËN PËR DATËN E ZGJEDHJEVE

FAQE 4-5



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, kanë zhvilluar një takim të përbashkët, në të cilin kanë folur për zhvillimet e përgjithshme në vend, duke

mos përjashtuar as shkuarjen në zgjedhje të parakohshme. Për këtë të fundit, Kurti ka thënë se ka shprehur interesim për të diskutuar me PDK-në, LDK-në dhe AAK-në. "Se cila është stina më e përshtatshme për zgjedhjet e

radhës, më mirë është në pranverë ose në vjeshtë", ka thënë Kurti. Ndërkaq, Krasniqi ka thënë se PDK-ja është e gatshme për një pajtim me të gjitha partitë parlamentare për ta caktuar datën e zgjedhjeve të reja

OSMANI THOTË SE SERBIA PO E NDIHMON RUSINË TË HAPË FRONT TË RI KUNDËR PERËNDIMIT

F. 3



KRYEZIU: NËSE LDK-JA DHE AAK-JA S'KANË FUQI PËR TA NXITUR DORËHEQJEN E KURTIT, ATËHERË TA PRESIN PËRFUNDIMIN E MANDATIT

F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

OPINION

ALEANCAT TONA NDËRMJET ANAMNEZËS SË MUNGUAR DHE ANNEZISË SË IMONUAR

F. 7

Milazim KRASNIQI



AKTUALE



RAMA NË TURNE EVROPIANË PËR TË MBLEDHUR MBËSHTETJE PËR PS-në

F. 3

SHBA I KËRKON IRANIT TË MOS I FURNIZOJË ME ARMË REBELËT HUTHI

F. 2

EKONOMI



BERZH-i, BE-JA DHE JAPONIA PËRFORCOJNË INVESTIMET BANESORE PËR KURSIM TË ENERGJISË NË KOSOVË

F. 8

BQK-ja: 2.5 MILIONË MONEDHA NGA 2 EURO JANË TËRHEQUR NGA QARKULLIMI

F. 8

SPORT



FETAHU DHE DUSHKU, PJESËMARRËS NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË FIBA EVROPËS

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Blinkeni u thotë ukrainasve se ndihma ushtarake “është rrugës”

KIEV, 14 MAJ - Ndhimja ushtarake amerikane për Ukrainën “është rrugës”, tha sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, në Kiev, më 14 maj, përderisa Rusia po vazhdon ofensivën e re në rajonin verilindor të Harkivit.

Vizita e paparalajmëruar e Blinkenit në Ukrainë po ndodh disa javë pasi Kongresi amerikan miratoi paketën e ndihmës ushtarake për Ukrainën në vlerë prej 61 miliardë dollarësh. “Në terma afatshkurtër, ndihma tani është rrugës dhe do të bëjë dallim të vërtetë kundër agresionit rus”, i tha ai presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky.

Blinkeni arriti gjatë natës me treg nga Polonia në vizitën e tij të katërt në Kiev, që kur ka nisur pushtimi rus i Ukrainës në shkurt të vitit 2022. Zelensky e falënderoi

Uashingtonin për ndihmë ushtarake duke thënë se “vendimi për paketën e ndihmës ishte crucial për ne”. Sipas tij, Ukraina më së shumti ka nevojë për mbrojtje ajrore, duke i kërkuar ShBA-së dy bateri të sistemit Patriot për rajonin e Harkivit, ku forcat ruse po kryejnë ofensivë të re. Ofensiva ruse në Harkiv nisi javën e kaluar dhe mijëra persona u evakuuan, ndërkaq Kiev mobilizoi përforsime për t'i dërguar në këtë rajon që gjendet në kufi me Rusinë. Blinkeni gjatë vizitës në Ukrainë do të takohet edhe me kryeministrin Denys Shmyhal dhe ministrin e Jashtëm ukrainas Dmytro Kuleba.

Në këto takime, sipas zëdhënësit të Departamentit Amerikan të Shtetit, Matthew Miller, kryediplomati amerikan dhe udhëheqja ukrainase do të



diskutojnë për “më të rejtat nga fushëbeteja, për ndikimin e ndihmës së re amerikane në fushën e sigurisë dhe ekonomisë dhe për zotimet

afatgjata për siguri dhe zotime të tjera”.

Vizita e fundit në Ukrainë e një zyrtari të lartë amerikan u zhvillua në mars, kur këshilltari

për siguri kombëtare, Jake Sullivan, vizitoi shtetin që po përballet me pushtimin e përvokuar që nisi Moska në shkurt të vitit 2022.

ShBA-ja i kërkon Iranit të mos i furnizojë me armë rebelët Huthi

WASHINGTON, 14 MAJ - Shtetet e Bashkuara i kanë bërë thirrje Iranit ta ndalë transferimin e sasisë së “paprecedent” të armëve për rebelët jemenas Huthi, që u mundësojnë atyre të kryejnë “sulme të pamatura” ndaj anijeve në Detin e Kuq dhe gjetkë.

Zëvendësambasadori amerikan Robert Wood tha se nëse Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dëshiron të bëjë përparim drejt dhënies fund të luftës civile në Jemen, duhet që në mënyrë kolektive “ta bëjë të qartë rolin destabilizues të Iranit dhe të insistojmë se ai nuk mund të fshihet prapa rebelëve Huthi”.

Ai tha se ka dëshmi të shumta që vërtetojnë se Irani u jep rebelëve Huthi armë të avancuara, përfshirë raketa balistike dhe lundruese. Kjo, sipas Wood, është



në kundërshtim me sanksionet e vendosura nga OKB-ja. “Për ta nënvizuar shqetësimin e Këshillit sa iu përket shkeljeve të vazhdueshme të embargos së

armëve, ne duhet të bëjmë më shumë që të mos shmangen sanksionet dhe t'i ndalim shkelësit e tyre”, tha Wood.

Rebelët Huthi kanë thënë se

sulmet e tyre ndaj anijeve në Detin e Kuq dhe Gjirin e Adenit synojnë t'i bëjnë presion Izraelit që t'i japë fund luftës së tij ndaj Hamasit - grupit palestinez të

shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në Gazë, që ka lënë të vrarë më shumë se 35 000 palestinezë.

Lufta nisi pasi Hamas sulmoi Izraelin më 7 tetor, duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë.

Rebelët Huthi që nga nëntori i vitit të kaluar kanë kryer mbi 50 sulme ndaj anijeve, kanë kapur një anije dhe kanë fundosur një tjetër, thanë autoritetet detare amerikane muajin e kaluar.

Javët e fundit janë pakësuar sulmet e rebelëve, pasi ata janë goditur nga fushata e sulmeve ajrore në Jemen, që udhëhiqet nga ShBA-ja.

Për shkak të rrezikut nga sulmet e rebelëve, kalimi i anijeve në Detin e Kuq dhe Gjirin e Adenit është rralluar.

Ligjvënësit në Gjeorgji miratojnë ligjin kontrovers për “agjentë të huaj”

SUHUM, 14 MAJ - Ligjvënësit në Gjeorgji e kanë miratuar projektligjin kontrovers për “agjentët e huaj” në leximin e tretë dhe të fundit.

Përgjatë seancës, 84 ligjvënës kanë votuar për, ndërsa 30 të tjerë kanë qenë kundër dokumentit të shndërruar në ligj.

Për disa javë rresht dhjetëra qindra gjeorgjianë kanë protestuar kundër projektligjit, i cili është çuar përpara prej partisë në pushtet, Ëndrra

Gjeorgjiane.

Protestat janë shtypur disa herë në mënyrë të dhunshme me topa uji, gaz lotsjellës dhe plumba gome, derisa edhe protestuesit janë sulmuar nga bandat apo plaçkitësit në orët e vona të natës.

Ligji do t'u kërkojë organizatave që pranojnë më shumë se 20 për qind të fondeve prej jashtë, që të regjistrohen si agjentë me ndikim të huaj.

Në rast të mosregjistrimit parashihet mbyllja e entiteteve

si dhe gjoba të ashpra.

Kundërshtarët e konsiderojnë dokumentin si “ligj rus”, duke e krahasuar me legjislacionin rus që përdoret për t'i shënjestruar kritikët e presidentit rus Vladimir Putin.

Megjithatë, Qeveria e Gjeorgjisë ka thënë se projektligji është i domosdoshëm për ta promovuar transparencën, për t'i luftuar “vlerat pseudo-liberale” të promovuara prej të huajve, si dhe për ta ruajtur sovranitetin e shtetit.



Osmani thotë se Serbia po e ndihmon Rusinë të hapë front të ri kundër Perëndimit

PRISHTINË, 14 MAJ - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka akuzuar Serbinë se po e ndihmon Rusinë, në mënyrë që, sipas saj, të shpërqundrohet vëmendja nga lufta që Moskë nisi më 2022 kundër Ukrainës, dhe të hapë “një front të ri kundër Perëndimit”.

Gjatë pjesëmarrjes në Samitin për Demokraci të Kopenhagës, Osmani tha se demokracia në botë është në sprovë pasi, sipas saj, autoritetet po sulmojnë vazhdimisht vlerat demokratike. Ajo tha se Kosova e sheh të ardhmen e saj në familjen euroatlantike dhe nuk do të ndalet së punuari në rrugën drejt integritimit euroatlantik. Por, sipas Osmanit, Serbia fqinje po përpiqet ta ndihmojë presidentin rus, Vladimir Putin, që t'i shtyjë përpara agjendat e tij në Ballkanin Perëndimor. “Siç e dini, Kosova kufizohet me Serbinë, vend që jo vetëm së voni, por sidomos së voni është dëshmuar të jetë dorë e zgjat, shumë besnike e Rusisë, që përpiqet të luajë me ato lojërat e [presidentit rus, Vladimir] Putinit në Ballkanin Perëndimor duke hapur një front të ri ndaj Perëndimit”, tha Osmani, duke shtuar se ky efekt

i shpërndarës me të cilin Rusia do ta arrinte shpërqundrimin e vëmendjes nga Ukraina, do të ishte shumë i nevojshëm për ta. “Pra, puna që mbajmë bashkë me aleatët tanë sepse, siç e dini, kemi një prani të NATO-s në Kosovë, për të siguruar që Kosova të mbetet e sigurt dhe stabile, është një gjë që bëjmë çdo ditë, çdo orë”, shtoi presidentja e Kosovës.

Serbia ka raporte miqësore me Rusinë dhe është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që u ka rezistuar thirrjeve të bashkësisë ndërkombëtare që të vendosë sanksione kundër Moskës për shkak të luftës së paprovokuar ndaj Ukrainës. Megjithatë, Serbia ka mbështetur disa rezoluta në Asambleenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara që kanë dënuar pushtimin rus të Ukrainës.

Gjatë samitit në Kopenhagë, Osmani tha se Kosova ka rritur bashkëpunimin me aleatët e saj për të zmbursur çdo qëllim “destabilizues në kufirin verior” - duke iu referuar kufirit me Serbinë. Në këtë kontekst, ajo përmendi sulmin e organizuar vitin e kaluar nga një grup i armatosur serbësh në Banjaskë të



Zveçanit. “Vitin e kaluar patëm një sulm të tillë. Ishte një sulm paramilitar që shkoi deri në akt të agresionit nga Serbia, por që arritëm ta kthenim mbrapshtë përkundër madhësisë së sulmit, sepse bashkëpunuam me aleatët tanë”, tha Osmani, duke mos përjashtuar mundësinë që një sulm i ngjashëm të përsëritet në të ardhmen.

Gjatë sulmit në Banjaskë është vrarë një rreshter i Policisë së Kosovës dhe në shkëmbimet

pasuese të zjarrit janë vrarë edhe tre sulmues serbë. Kosova e ka fajësuar Serbinë se qëndron prapa sulmit, por Beogradi ka mohuar se ka gisht në të. Përgjegjësinë për sulmin e armatosur në Banjaskë e ka marrë Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit. Pas sulmit, autoritetet në Kosovë kishin thënë se po hetonin përfshirjen e mundshme të

Rusisë për sulmin në Banjaskë të Zveçanit.

Zyrtarët e lartë në Kosovë vazhdimisht kanë thënë se Serbia mbështet agjenda destabilizuese të Rusisë në Ballkanin Perëndimor.

Ndërsa presidenti rus, Vladimir Putin, disa herë ka përmendur Kosovën kur ka justifikuar nisjen e pushtimit të Ukrainës fqinje. E një krahasim të tillë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka cilësuar injorancë.

Rama në turne evropianë për të mbledhur mbështetje për PS-në

TIRANË, 14 MAJ - Me Greqinë, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, nisi një turne që synon mbledhjen e mbështetjes për Partinë e tij Socialiste edhe në mesin e diasporës shqiptare. Anëtarësimet e reja në PS dhe investimet në Shqipëri janë qëllimet e deklaruara të Ramës.

Ndërsa të radhës do t'i ketë: Italinë, Gjermaninë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Në Athinë, të dielën e 12 majit, ai u takua me mijëra emigrantë, përfaqësuesit e të cilëve thonë se kishin pritje më të mëdha prej tij në lidhje me disa probleme me të cilat përballen.

Në Shqipëri, pushteti e cilësoi takimin të frytshëm, ndërsa opozita “propagandë”.

Gjatë takimit me emigrantët në një sallë të stadiumit “Galatsi” në kryeqytetin grek, Rama bëri thirrje për një histori të re në marrëdhëniet Shqipëri - Greqi. “Shqipëria nuk ka asnjë pretendim tjetër ndaj Greqisë përveç respektit reciprok, kujdesit reciprok për bashkëkombësit që jetojnë në të dyja shtetet tona, marrëdhëniet reciproke të miqësisë dhe të fqinjësisë së mirë... Shqipëria e sheh Greqinë si një partner të natyreshëm strategjik”, tha Rama. Ai pranoi se në dhjetë vjet të qeverisjes ka bërë, siç tha, edhe gabime, por “në asnjë rast nuk i



ka shitur interesat e shqiptarëve”. Rama theksoi se është absurde që Greqia mban ende në fuqi ligjin e luftës me Shqipërinë - një ligj që e hoqi me Italinë.

Ai kujtoi, siç u shpreh, sakrificat e shqiptarëve - nga detyrimi “për t'i ndryshuar emrat në greqisht” deri te “përballja me operacionet e largimit të atyre pa dokumente nga Greqia”.

Rama i cilësoi emigrantët si “zot të barabartë shtëpie, e jo shërbëtorë të dikurshëm të Greqisë”. Sipas tij, mes dy vendeve ka negociata dhe, së shpejti, ato pritet të pajtohen për

njohtjen e pensioneve të emigrantëve shqiptarë, si dhe për disa lehtësime në përfitimin e shtetësisë greke. “Më në fund kemi arritur të çelim negociata në nivel ekspertësh për marrëveshjen e pensioneve me Greqinë. Po ashtu, kemi hapur edhe dialogun dypalësh në nivel teknik për problematikën e lejeve të qëndrimit dhe procedurën e marrjes së shtetësisë me natyralizim. Ka goxha progres dhe jam besimplotë që shumë shpejt do të merrni lajme shumë të mira”, tha Rama, por nuk dha ndonjë afat konkret.

Diaspora në Shqipëri nuk është e regjistruar por, sipas një raporti të Institutit të Statistikave në vitin 2020, numri i emigrantëve pas viteve '90 ka arritur në rreth 1.68 milion.

Në Greqi jetojnë rreth 500 mijë shqiptarë. Përfaqësues të diasporës atje thonë se shqiptarët nuk janë të integruar si komunitet, por si individë. Mijëra shqiptarë në Greqi nuk arrijnë të përfitojnë pension, pasi nuk ka marrëveshje mes dy vendeve për t'i njohur sigurimet shoqërore. Shqiptarët në Greqi janë

përballur shpesh me probleme edhe sa i përket pajisjes me leje të qëndrimit dhe marrjes së shtetësisë për shkak të ndryshimeve të herëpashershme të ligjeve dhe vendimeve qeveritare, por edhe kohës së shkurtër në dispozicion për rinovimin e dokumenteve.

Një gjë e tillë ka çuar edhe në kthime masive të shqiptarëve, apo moslejim të kalimit të kufirit të atyre që kanë qenë në Shqipëri në kohën kur kanë ndodhur ndryshimet.

Në përpjekje për ta nxitur investimin e emigrantëve në Shqipëri, qeveria e Ramës ka organizuar tri samite të diasporës. Takimi i Ramës në Greqi nxitë reagime edhe në disa medie greke, të cilat e cilësuan si “provokim” pasi, siç u tha, u realizua në njëvjetorin e rastit të Alfred Belerit.

Beleri ka garuar për kryetar bashkie në qytetin jugor shqiptar të Himarës, më 13 maj të vitit 2023, nën siglën e një partie të minoritetit grek, të lidhur me një koalicion opozitar.

Beleri është arrestuar në mes të atij maji, nën dyshimet për blerje votash. Ai mbetet në burg si i dënuar. Rasti ka shkaktuar protesta të zhurmshe nga Greqia dhe akuza nga Tirana se Athina po ndërhyr në drejtësinë e Shqipërisë.



Kurti shpreh gatishmëri me opozitën për datën e zgjedhjeve

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, kanë zhvilluar një takim të përbashkët, në të cilin kanë folur për zhvillimet e përgjithshme në vend, duke mos përjashtuar as shkuarjen në zgjedhje të parakohshme. Për këtë të fundit, Kurti ka thënë se ka shprehur interesim për të diskutuar me PDK-në, LDK-në dhe AAK-në. “Se cila është stina më e përshtatshme për zgjedhjet e radhës, më mirë është në pranverë ose në vjeshtë”, ka thënë Kurti. Ndërkaq, Krasniqi ka thënë se PDK-ja është e gatshme për një pajtim me të gjitha partitë parlamentare për ta caktuar datën e zgjedhjeve të reja

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

Prishtinë, 14 maj - Kryeministri i Kosovës Albin Kurti, ka thënë se është i interesuar të diskutojë me subjektet politike për datën më të përshtatshme për zgjedhjet e reja parlamentare në Kosovë. Ai i ka bërë këto deklarata pas një takimi të zhvilluar me kryetarin e partisë opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi. Kryetarët e partive të tjera opozitare, ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), dhe ai i Aleancës për Ardhmërinë

e Kosovës (AAK), e kanë refuzuar ftesën për takim.

Mandati katërvjeçar i qeverisë aktuale përfundon në fillim të vitit 2025. “Që nga marsi i këtij viti nuk mund të themi që zgjedhjet e radhës janë çështje të viteve, por të muajve, andaj unë jam i interesuar të diskutoj me PDK-në, LDK-në dhe AAK-në se cila është stina më e përshtatshme për zgjedhjet e radhës. Më mirë është në pranverë ose në vjeshtë”, ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se do t'i vazhdojë diskutimet në këtë drejtim edhe me partitë e tjera opozitare. “Për

mua nuk është thelbësore se a do të qeveris në këtë mandat edhe 10 muaj, tetë apo gjashtë muaj apo tre muaj. Është e rëndësishme të kemi një konsensus sa më të gjerë për muajin, datën e zgjedhjeve”, është shprehur Kurti.

Megjithatë, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se do ta mbështesë “shpërbërjen e Parlamentit vetëm pas dorëheqjes apo shkarkimit të kryeministrit”. “Në situatën në të cilën jemi aktualisht, të gjitha dështimet e Kosovës, brenda dhe jashtë, e kanë vetëm një emër - qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Kurti ka thënë se me Krasniqin kanë diskutuar edhe për rëndësinë e një komunikimi më të mirë në ditët në vijim, me qëllim të miratimit të 13 marrëveshjeve ndërkombëtare që janë në pritje për t'u votuar në Kuvendin e Kosovës.

Kryetari i PDK-së, në anën tjetër, ka thënë se zgjedhjet e reja janë të domosdoshme. “Ne nuk jemi në gjendje të mirë. Kosova është në agoni. Kemi një ekonomi të stagnuar, rritje enorme të çmimeve, me paga dhe pensione të vogla, të cilat nuk u mjaftojnë

familjeve kosovare ta lidhin muajin me muaj”, ka thënë Krasniqi, duke kritikuar punën e qeverisë aktuale edhe në sektorin e shëndetësisë, arsimit dhe politikës së jashtme.

Krasniqi ka thënë pas takimit me Kurtin se PDK-ja është e gatshme “të gjejë një darkordim me të gjitha partitë parlamentare për një datë të re të zgjedhjeve, për të shpërndarë Kuvendin përmes një mocioni të përbashkët”.

PDK-ja e ka përcaktuar Bedri Hamzën kandidat për kryeministër në zgjedhjet e radhës.

Rreth takimit Kurti - Krasniqi, ka njoftuar më gjerësisht edhe Qeveria e Kosovës përmes një njoftimi për medie. “Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga kryetarja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje!, Mimoza Kusari-Lila, zhvilloi një darkë pune me kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi dhe kryetarin e grupit parlamentar të PDK-së, Abelard Tahiri. Kjo darkë u zhvillua me ftesë të kryeministrit Kurti. Temë qendrore e diskutimit ishte mbarëvajtja e punës së Kuvendit dhe përmeshja e agjendës

legjislative në Kuvend për sesionin pranveror, përkatësisht votimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. Janë 13 marrëveshje ndërkombëtare të cilat janë në pritje për t'u votuar, e për çka nevojiten 2/3-tat e deputetëve në Kuvend”, thuhet në njoftimin e qeverisë.

Më tutje thuhet se kryeministri theksoi se me 224 ligje të votuara në dy lexime deri më tani, legjislatura e dalë nga zgjedhjet e shkurtit 2021 ka shënuar rekord të ri të ligjeve të votuara që prej pavarësisë së vendit. “Ky numër mund të rritet edhe më tej por që, për çështje të caktuara, sikurse marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligje të caktuara, nevojitet edhe mbështetja dhe kontributi i partive të tjera parlamentare. Krahas kësaj, u diskutua edhe për aktualitetin politik, ecjen e Republikës së Kosovës në integrimet ndërkombëtare, dhe për mundësitë për zgjedhjet e reja në të ardhmen e afërt, teksa qeveria ka hyrë në vitin e fundit të mandatit të saj. Kryeministri Kurti falënderoi udhëheqësit e Partisë Demokratike të Kosovës, kryetarin Memli Krasniqi dhe kryetarin e grupit parlamentar, Abelard Tahiri, që iu përgjigjen

Kryeziu: Nëse LDK-ja dhe AAK-ja s'kanë fuqi për ta nxitur dorëheqjen e Kurtit, atëherë ta presin përfundimin e mandatit

PRISHTINË, 14 MAJ - Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka komentuar takimin në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe Memli Krasniqi dhe refuzimin e LDK-së dhe të AAK-së për të marrë pjesë në këtë takim. Ai ka thënë se LDK-ja dhe AAK-ja, nëse nuk kanë fuqi politike për ta nxitur dorëheqjen e kryeministrit, atëherë alternativa e tyre është

se kjo qeveri ta përfundojë mandatin qeverisës. "LDK-ja dhe AAK-ja, nëse nuk kanë fuqi politike për ta nxitur dorëheqjen e kryeministrit, refuzojnë votën e tyre për shpërndarjen e kësaj legjislature, atëherë alternativa e tyre është që kjo qeveri ta përfundojë mandatin qeverisës dhe të shkojmë në zgjedhje të rregullta. Nëse LDK-ja dhe AAK-ja si parti opozitare

mendojnë se kjo qeveri i ka sjellë shumë dëme vendit dhe duhet të ndalohej kjo formë e qeverisjes?! Nëse tani i kanë të renditura shumë argumente për ngecjet dhe dështimet e kësaj qeverie, në disa fusha të politikës, si: në zhvillimin ekonomik, në qeverisjen llogaridhënëse, transparente dhe pa korrupsion, fuqizimin e aleancave dhe partneritetit ndërkombëtar, rrugëtimin

euroatlantik, anëtarësimin në KiE, dialogun me Serbinë etj.. S'di pse alternativën e tyre politike duhet ta fokusojnë në formë, se si i ndërpritet mandati kësaj qeverisje!? Gjithnjë forma ka rëndësi se si një veprim politik pranohet dhe perceptohet nga publiku, por jo mbi përmbajtjen. Përmbajtja është thelbësore në politikë", ka shkruar Kryeziu në "Facebook". Ai ka thënë se më shumë sesa

forma, se si të arrihet ndërprerja e një mandati të një qeverie, politikisht për opozitën është zgjidhje më e mençur ndërprerja e një mandati të qeverisë para kohe sesa shkuarja në zgjedhje të rregullta. "Dhe përmbajtja e një mandati qeverisës dhe shkuarja në zgjedhje të rregullta janë formë e ndikimit dhe perceptimit në publik!?", ka shkruar Kryeziu.



pozitivisht ftesës për një darkë pune sonte. Ai është i gatshëm dhe i interesuar t'i takojë edhe përfaqësuesit e partive të tjera parlamentare për të zhvilluar diskutime të ngjashme me ato të sontshme", është theksuar në njoftimin e Qeverisë së Kosovës. Lidhja Demokratike e Kosovës ka reaguar në lidhje me zhvillimet e fundit politike në vend. Sipas LDK-së, zgjidhja është fare e thjeshtë, dorëheqja e kryeministrit dhe pastaj, si rrjedhojë, shpërbërja e Kuvendit. "Pas tre vjet e gjysmë populizëm dhe pa ndonjë progres thelbësor, pas tre vjet e gjysmë polarizimi, ndarjeje shoqërore e nxitje të propagandës pa asnjë konsideratë njerëzore e politike, kryeministri i Kosovës ka zgjedhur instrumentalizimin e opozitës si shpëtim individual nga dështimi i madh. Fatkeqësisht, në këtë instrumentalizim, ka gjetur aleatin. LDK-ja nuk e pranon këtë instrumentalizim në asnjë rrethanë. LDK-ja është e gatshme

Takimi Kurti - Krasniqi, vijnë reagimet negative dhe pozitive

Opinionisti Lirim Mehmetaj ka thënë se pas nënshtrimit ndaj Albin Kurtit dhe dështimit në krye të Partisë Demokratike, Memli Krasniqi, ose duhet të shkojë të anëtarësohet në Vetëvendosje ose ta përzënë vetë anëtarët e PDK-së. "Në vend se ta intensifikojë opozitëbërjen si nevojë jetike për shtetin në këtë dakik të ligë, ai ka zgjedhur të bëjë muhabetë qosheve të përzgjedhura nga autori i kësaj situatë Albin Kurti. Elektorati i PDK-së duhet ta dijë se PDK-ja fillimisht e më pas Kosova është shumë më e madhe se sa komoditetet e Memli Krasniqit e Uran Ismailit dhe tek e fundit

askush s'iu ka borxh që për qëllime të tyre personale ta shesin interesin e Kosovës. PDK-ja nga sot pa asnjë diskutim mund të thuhet se udhëhiqet nga një klikë e dorëzuar dhe e nënshtruar te Albin Kurti që jo vetëm se nuk përfaqëson interesat e Kosovës, por as të anëtarësisë së partisë së vet", ka shkruar Mehmetaj në "Facebook".

Edhe opinionisti Artan Behrami ka theksuar se opozita në Kosovë që nga fillimi ka ndjekur një rrugë jo të hakmarrjes, jo të konfrontimit, jo të imitimit të dhunës politike që dikur e kishte ndjekur Lëvizja Vetëvendosje. "Ndoshta unë ia kisha bërë

ndryshe! Por, kjo është e parëndësishme! Parimisht, takimi mes Memlit me Albinin është një rrjedhë logjike, meqë opozita ka ndjekur rrugën e pjekurisë politike!

Takimi me Kurtin do të ishte një 'NO GO' veç nëse opozita që nga fillimi kishte ndjekur një opozitëbërje radikale. Por, pasivitetin e tyre trevjeçar nuk mund ta zëvendësojnë me arrogancë në minutat e fundit të ndeshjes! Prandaj, Memli dhe PDK-ja kanë bërë mirë që kanë shkruar, meqë synimi i tyre është që vendi të shkojë sa më shpejt në zgjedhje", ka shkruar Behrami në "Facebook".

të kërkojë besim qytetar, e gatshme të marrë përgjegjësinë para sfidave, e gatshme të implementojë 'Rrugën e Re' si program zhvillimor, të djathtë e

euroatlantik. Për këtë, duhet dorëheqja e kryeministrit, si rruga e duhur drejt shpërbërjes së Kuvendit dhe shkuarjes në zgjedhje të parakohshme.

Dorëheqja, më pas shpërbërja dhe në fund data. Ky është rendi i gjërave", është thënë në komunikatën e LDK-së.

LDK-ja ka theksuar se refuzon

farsën e darkave si mbulesë të një uniteti politik që u përbuz kur u ofrua tash e tre vjet e gjysmë. "LDK-ja thërret për një unitet të djathtë gjithëkombëtar, si lidhje përtejpartiake, si lëvizje shpëtimtare. Gjendja e tanishme, politike, ekonomike, diplomatike e sociale kërkon leadership të ri në Kosovë. Rëndesa ekonomike, pagat e ulëta, çmimet e larta, sistemi shëndetësor i rrënuar e arsimit i mbetur prapa, sikurse dhe ngecjet enorme integruese për në BE e anëtarësuese për në NATO, po shkaktajnë çdo ditë zbrazjen e Kosovës, me nga 173 qytetarë duke u larguar nga vendi ynë çdo ditë e secilën ditë. LDK-ja nuk do të bëhet pjesë e asnjë marrëveshjeje të prearanzhuar prapa dyerve të mbyllura e darkave. LDK-ja fton të gjitha palët politike, që në këtë kohë, të kërkojnë dhe të punojnë vetëm në drejtim të dorëheqjes legale të kryeministrit, sepse ajo faktike tashmë ka ndodhur", theksohet në komunikatën e LDK-së.

ALEANCAT TONA NDËRMJET ANAMNEZËS SË MUNGUAR DHE AMNEZISË SË IMONUAR

Fuqia ushtarake e UÇK-së mund të ketë qenë më e vogël sesa ajo e lëvizjes partizane, por mençuria politike e transformoi në një ushtri fitimtare, natyrisht në krahun e NATO-s. Pra, mençuria e udhëheqësve të projekteve mund të ketë ndikim në zhvillimin e ngjarjeve, çka e bën të rëndësishëm rolin e elitave dhe aftësinë e popullit që të orientohet në pajtim me interesat vitale



Milazim KRASNIQI

Raporti i shqiptarëve të sotëm dhe i paraardhësve të tyre ilirë, me popuj e shtete të tjera, kësaj radhe me theks tek aleatët, duhet të jetë objekt i një historie kritike, ku do të analizoheshin e ballafaqoheshin të gjitha burimet ekzistuese dhe do të vlerësoheshin realisht të gjitha ato zhvillime, pra si një histori e raporteve të shqiptarëve me aleatët. Por, ne një histori të tillë nuk e kemi ende dhe me gjasë nuk do ta kemi edhe për një kohë të gjatë, për aq kohë sa nuk ndiejmë nevojë për t'u shkëputur nga interpretimet jokritike e edhe pseudoshkencore për të kaluarën tonë. Prandaj na ndodhë jo rrallë që për të njëjtën ngjarje të kemi interpretime diametralisht të kundërta, gjë që e shton konfuzionin dhe e mjegullon të vërtetën. Ne na ndodhë jo rrallë madje që aleatët t'i përjetojmë ose t'i paraqesim si armiq, ndërsa armiq të t'i paraqesim si aleatë. E vërteta është se ka pasur edhe ndërrim rolesh të tyre nëpër kohë, pra kalim nga njëri status tek tjetri, një ngatërrim fatkeq, pak a shumë të ngjashëm me skenën e fundit të romanit "Ferma e kafshëve" të Xhorxh Orvellit, ku në një zënkë ndërmjet njerëzve e derrave, rolet përzihen aq shumë sa që është vështirë të dallohet cili është derri e cili njeriu. Aleatët tanë shpesh janë në aso pamjesh të përziera.

Disa nga faktorët që formojnë dhe shformojnë aleancat tona

Në rastin tonë konkret, pra ilir e shqiptar, në krijimin dhe

prishjen e aleancave kanë ndikuar disa faktorë, nga të cilët ne këtu po i skicojmë vetëm disa që na duken relevantë e mbase edhe aktualë: përkatësia gjeografike, fuqia ushtarake, mençuria politike dhe fatet e fshehta, që nuk i rrokë logjika historike. Në rastin tonë, nga periudhat helenike e romake, përkatësia gjeografike ka qenë me rëndësi për raportet me fqinjët e edhe për aleancat e ndryshme. Që nga pjesëmarrja e disa fiseve ilire në luftën e Trojës, mbase në taborët e kundërvëna, ka vazhduar ajo ngatërrësë në aleanca e armiqësi të pandërprera. E drejta, para sundimit romak, kund në shekullin V-IV para erës sonë, Pseudo Skymni e përshkruante Ilirinë si një vend me shumë banorë, në paqe, liri e begati dhe ku njerëzit bënë një jetë të hijshme. Mirëpo shkatërrimi tragjik i asaj jetese të hijshme, erdhi si pasojë e pushtimeve romake (229-228, 119-218) dhe veçmas të vitit 163, me kapitullimin e Gentit, i cili pati një aleancë antiromake me mbretin maqedon, Filipin. Ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë se a ka qenë aleancë e imponuar përballë mujshisë romake, por e dimë se nga ajo aleancë Iliria më kurrë e ka marrë veten, kurrë më nuk ka pasur gjasa të ribëhet. Shkatërrimet që bënë Anici dhe Paul Emili në Epir dhe në Iliri janë shënuar në histori si shkatërrim sistematik i mbi tetëdhjetë qyteteve dhe plaçkitje e paimagjinueshme e pasurive të arit. Pra, përkatësia gjeografike, të gjendurit në pjesën lindore të Adriatikut, në rrugën e Romës për ekspansion drejt Lindjes, ka qenë fatale për Ilirinë, ndërsa aleanca e gabuar, ka qenë e imponuar nga ai realitet. Edhe në shekujt e mëvonshëm, në kohën e dyndjeve sllave, në kohën e kryqëzatave, të ekspansionit osman, më vonë të atij austro-hungarez, italian, gjerman, jugosllav e rus, pozita gjeografike në këtë udhëkryq të kontinentit tonë, ka pamundësuar që të arrihen

aleanca racionale, po shumica kanë qenë të imponuara. (Në poezinë me titull "Monedha e Gentit" këtë dilemë tonën gjeografike e kam sublimuar në vargjet "Në një rën anë shungullon nga deti/në tjetrën ulërin nga mali", pra në një rën anë ishte peshkaqeni, në tjetrën në ishte luani.) Prandaj fuqia ushtarake, sado që të ketë qenë, në kohë e situata të ndryshme, më të shumtën ka qenë e pamjaftueshme për t'u imponuar si aleat kredibil, në raport me shtete perandorake e imperiale, Romën, Bizantin, Bullgarinë, Serbinë mesjetare, shtetin anzhuin, Venedikun, Napolin, Shtetin Osman, Italinë fashiste, Gjermaninë naziste, Jugosllavinë komuniste, BRSS bolshevikë, Kinën maoiste. Pra, pothuajse vazhdimisht kemi qenë përballë fuqive të mëdha, me të cilat fuqia ushtarake ka qenë në disproporcion të madh. Rrjedhimisht jo gjithmonë ka pasur sukses në imponimin ose mbrojtjen e interesave strategjike. Ndërsa sa i përket mençurisë së udhëheqësve, edhe ajo ka pasur ndikim e veta, herë fatale herë fatlume. Po i përmend vetëm dy shembuj, sa për ilustrim. Nga fundi i Luftës së Dytë Botërore lëvizja partizane ishte aleate e Britanisë së Madhe dhe e SHBA-së, të cilat e furnizuan me armë dhe e fuqizuan aq sa ia mundësuan që të dilte forca fituese në skenën e luftës në Shqipëri. Por, ajo aleancë u shkatërrua pas dy vitesh, pas incidentit të Korfuzit, duke e shndërruar Shqipërinë në armik të tërbuar të Britanisë së Madhe dhe të SHBA-së, për gati gjysmë shekulli. E kundërta ndodhi me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ajo lindi si një lëvizje guerile, me parashenjë majtiste, deri diku enveriste, por gjatë zhvillimeve të shpejta, u shndërrua në aleate besnike të SHBA-së dhe NATO-s. Fuqia ushtarake e UÇK-së mund të ketë qenë më e vogël se sa ajo lëvizjes partizane, por mençuria politike e transformoi në një ushtri fitimtare, natyrisht në krahun e NATO-s. Pra, mençuria e udhëheqësve të projekteve mund të ketë ndikim në zhvillimin e ngjarjeve, çka e bën të rëndësishëm rolin e elitave dhe aftësinë e popullit që të orientohet në pajtim me interesat vitale. Ne shqiptarët ende nuk e kemi arritur nivelin kritik të të kuptuarit të rolit të elitave. Prandaj edhe kemi me raste lëkundje, hutesa, oscilime dhe gabime. Mjafton të

përmendim këtu trazirat e dhunshme të vitit 1997 në Shqipëri dhe të vitit 2004 në Kosovë, të cilat tronditën kombin deri në themel dhe patën elemente të kundërvënies ndaj aleatëve strategjikë, veçmas në Kosovë. Është e vështirë të kuptohet se si ka qenë e mundshme që vetëm pesë vite pas çlirimit të Kosovës nga NATO, protestuesit shqiptarë në Kosovë të konfrontohen me ushtarët e NATO-s.

Në rastin tonë Vullneti Hyjnor si faktor shpëtimtar ekziston

Lidhur me fatet e fshehta, ato që nuk i rrokë logjika historike, në historinë tonë të re ka disa shembuj indikativë. Fjala vjen, në Luftën e Parë Ballkanike ishte planifikuar çrënjosja e të gjithë muslimanëve nga Ballkani, pra në rend të parë të shqiptarëve, si komb me shumicë absolute myslimane. Ka burime të besueshme që konfirmojnë se projekti e kishte edhe miratimin e disa fuqive të mëdha evropiane, pra jo vetëm të shteteve ballkanike e Rosisë. Projekti do të zbatohet plotësisht, po të mos shkaktohej Lufta e Dytë Ballkanike ku shtetet ballkanike, Serbia e Greqia (po edhe Rumania) u futën në luftë kundër Bullgarisë, me çka shpëtuan shqiptarët në Ballkan po edhe Edreneja dhe vetë Stambolli. Pas Konventës jugosllave-turke të vitit 1937 filloi sërish shpërngulja e shqiptarëve, por nuk u realizua deri në fund ngase në vitin 1941 Gjermania e pushtoi Jugosllavinë, duke e ndërprerë projektin e dëbimit të shqiptarëve dhe të copëtimit të Shqipërisë sipas elaboratit të Ivo Andriqit. Edhe projekti i Millosheviqit i viteve 1998-1999 ishte për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova por edhe ai u pengua nga bombardimet e NATO-s. Këto fate të fshehta mund t'i quajmë vullneti i Zotit, sepse nuk janë brenda asaj që ne quajmë logjikë historike. Bile mund të thuhet se brenda logjikës historike ilirët do të ishin zhdukur të mullirin e romanizimit, ata që mbetën të paromanizuar do të ishin bluar në mullirin e helenizimit e të sllavizimit. Por, mbijetuan dhe e konfirmuan identitetin e veçantë ilir-shqiptar, duke përfutur një komb të ri e dinamik në zemër të Ballkanit. Bindja ime është se në fatet e popujve, krahas përkatësisë

gjeografike, fuqisë ushtarake, mençurisë politike, ka ndikim edhe Vullneti Hyjnor. Arsyet e aktivizimit të Vullnetit Hyjnor ne nuk mund t'i kuptojmë, por ne mund ta evidentojmë si fakt që ndodhë në realitetin historik.

Aleanca e sotme dhe kryedilema e sotme

Historia e shqiptarëve në Ballkan ka hyrë në një epokë të re pas rënies së Murit të Berlinit, pas shpërbërjes së BRSS e të RFJ të Jugosllavisë, gjë që mundësoi çlirimin e Kosovës në vitin 1999 dhe vendosjen e trupave të NATO-s në territorin e saj, sado që nën një emër të një trupe paqeruajtëse të OKB-së. Shpërbërja e RFSJ/RFJ mundësoi lindjen e disa shteteve të reja në Ballkan, të cilat orientim strategjik e patën futjen në NATO. Rrjedhimisht, për ne si shqiptarë kulminacioni i kësaj historie është pranimi i Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe të Malit të Zi në Aleancën Veriatlantike. Në shekullin tonë, kjo është kryealeanca në të cilën aderojnë dhe participojnë shqiptarët si komb, sado të ndarë në disa shtete. Mbrojtja kolektive që siguron NATO, e bën më të sigurt ekzistencën dhe zhvillimin e kombit shqiptar. Kjo vlen sidomos për shqiptarët në shtetet që tashmë janë anëtarë të NATO-s, jo domosdoshmërisht për Kosovën në fazën e tashme, kur prezencën e NATO-s është e mandatuar nga rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe si e atillë teorikisht mund të tërhiqet. Por, përderisa të vazhdojë të jetë Rusia kërcënuese për Evropën/Perëndimin dhe përderisa Serbia të jetë shtet vasal i Rosisë, edhe siguria e Kosovës mbetet e fortë në këto konfrontime gjeopolitike, sepse pashmangshëm është aleat i Perëndimit. Por në rast se Serbia shkëputet nga Rusia dhe futet në orbitën atlantike, atëherë çmimi i atij ndryshimi mund të reflektohet edhe në Kosovë. Prandaj në këto realitete të aleancave të favorshme që kemi ne shqiptarët aktualisht, duhet të rritet koordinimi brendashqiptar, që të ndodhë faktorizimi shqiptar brenda sferës euro-atlantike po edhe përballë pretendimeve pansllaviste. Pse? Sepse Kosova ende mbetet dilemë gjeostrategjike e kulturore.

Funksionalizohet Zyra për Rikthimin e Aseteve në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

PRISHTINË, 14 MAJ - Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në takim të thirrur nga Udhëheqësi i Zyrës për Rikthim të Aseteve, Bahri Hyseni, me përfaqësuesit e institucioneve ligjzbatuese, konkretisht nga Policia e Kosovës, Njësi për Inteligjencë Financiare, Agjencia për Menaxhimin e Aseteve të Konfiskuara dhe të Sekuestruara, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës. Gjatë këtij takimi u bë funksionalizimi i Zyrës për Rikthimin e Aseteve, e cila është themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe

ofron ndihmë dhe këshilla për gjurmimin e pasurisë, bashkëpunimin me institucione financiare, kontabilitet forenzikë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për arritjen e synimeve të prokurorëve të rastit për kthimin e pasurisë së fituar përmes veprës penale. Me këtë rast ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, përshëndeti funksionalizimin e kësaj zyre, duke falënderuar përfaqësuesit e Institutit të Bazelit për Qeverisje dhe UNDP-së për mbështetjen dhe ndihmën e dhënë në formë të ndryshme për themelimin e Zyrës së Rikthimit të Aseteve dhe shprehu gatishmërinë e tij për



bashkëpunim me të gjitha institucionet e tjera ligjzbatuese me qëllim të funksionimit sa më të mirë të kësaj zyre.

Po në këtë takim prokurori nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, njëkohësisht Udhëheqës i Zyrës për Rikthim të Aseteve, Bahri

Hyseni, i njoftoi përfaqësuesit e institucioneve ligjzbatuese për rolin dhe kompetencat e kësaj zyre, ndërkaq zyrtarët e deleguar paraqitën ekspertizën e tyre të deritanishme.

Temë e diskutimeve të përbashkëta gjatë këtij takimi ishte edhe plani për procedurat standarde të veprimit, hapat e ardhshëm të Zyrës, si dhe planifikimi i aktiviteteve në terren.

Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, të Ambasadës Britanike në Prishtinë, të Zyrës së UNDP-së në Kosovë dhe të Zyrës së BE-së në Kosovë.

Bislimi në Institutin Hungarez të Çështjeve Ndërkombëtare flet për objektivat në procesin e integrimit evropian

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 MAJ - Në qëndrimin e tij në Budapest, zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ishte i ftuar në Institutin Hungarez të Çështjeve Ndërkombëtare (HIIA), ku ligjëroi dhe bashkëbisedoi me përfaqësues të institutit e ku pjesëmarrës në audiencë ishin edhe diplomatë, njohës të çështjeve ndërkombëtare dhe studentë. Gjatë fjalës së tij hyrëse, zëvendëskryeministri përmendi shkallën impresionuese të uljes së papunësisë në vend si dhe rritjen ekonomike e indikatorët



makro-ekonomikë pozitivë të cilët përmirësuan performancën e shtetit në tri vitet e fundit. Duke theksuar se regjistrimi i

popullsisë i cili po zhvillohet është i rëndësishëm për pajisjen me të dhëna të sakta e ngritjen e politikave të mirë targetuara, ai

shtoi se në vazhdimësi është punuar për përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve pa dallim. Bislimi nënvizoi se zhvillimi që ka njohur vendi ynë ka ardhur përtej barrierave me të cilat jemi përballur dhe se eliminimi i tyre zgjeron mundësitë, kapacitetet e potencialin tonë për avancim të mëtejshëm demokratik. Më tej, ai theksoi se është e rëndësishme të sigurohemi që kjo rritje ekonomike të jetë e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Përmendi edhe arritjen e liberalizimit të vizave, aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian në dhjetor 2022, si dhe synimet e objektivat e vendit në procesin e integrimit evropian në prag

edhe të presidencës së ardhshme të Këshillit të BE-së nga Hungaria, rëndësinë e zgjerimit dhe Planit të Rritjes të BE-së, punën e përpjekjet tona në këtë drejtim si dhe rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.

Zëvendëskryeministri Bislimi i falënderoi përzemërsisht të gjithë pjesëmarrësit për interesimin e shfaqur për ta njohur më shumë situatën në vend, sfidat me të cilat përballet Kosova dhe objektivat tona për të ardhmen. Para fillimit të sesionit të diskutimit, zëvendëskryeministri Bislimi u mirëprit në takim edhe nga drejtuesi i këtij instituti, Gladden Pappin.

Edhe një projekt nis Kurti, vendos gurthemelin e urës në fshatin Hajnoc të Kamenicës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

KAMENICË, 14 MAJ - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq dhe kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ndalesën e radhës në komunën e Kamenicës e kanë pasur në fshatin Hajnoc, që banohet me shumicë serbe, me rastin e vënies së gurthemelit tek ura për këmbësorë. Kurti është mirëpritur nga përfaqësuesi i fshatit, Radovan Antiq dhe banorët e fshatit.

Rregullimi i urës për këmbësorë, e cila kalon mbi lumin Morava, që lidh fshatin Hajnoc me qytetin dhe fshatrat e tjera, ka

qenë kërkesë e banorëve që jetojnë aty. Për realizimin e këtij projekti, komuna e Kamenicës ka ndarë mbi 85 mijë euro.

Gjatë inaugurimit kryeministri Kurti u shpreh se janë të interesuar t'u ndihmojnë sa më shumë qytetarëve pasi që, sipas tij, ata e kanë dëshmuar përkushtimin e tyre me punë të ndershme, me angazhim qytetar, gjithashtu edhe me këtë bashkëjetesë që është shembull për mbarë Kosovën.

Ai falënderoi kryetarin Rahimaj dhe ministrin Rashiq për punën dhe angazhimin në adresimin dhe realizimin e kësaj kërkesë të drejtë dhe nevojë të banorëve të këtij fshati.

Radovan Antiq, banor i fshatit, teksa u shpreh falënderues për

projektin në fjalë, tha se urat janë të rëndësishme për ne, sepse ato bashkojnë njerëzit e fetë e bashkojnë të gjithë njerëzit qëllimshëm.

Ndërkaq ministri Rashiq theksoi se kryeministri Kurti ka treguar gjithmonë gatishmërinë dhe vendosmërinë për të ndihmuar në të gjitha problemet e sfidat e qytetarëve tanë dhe falënderoi banorët e fshatit për nismën e tyre e kryetarin e komunës për bashkëpunimin e ngushtë.

Për urën kryesore, krahas kësaj për këmbësorë, që do ta lidhë fshatin Hajnoc me qytetin dhe fshatrat e tjera përreth, foli kryetari i komunës, Kadri Rahimaj, i cili njoftoi se Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht ministria e



Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, tashmë ka ndarë 700 mijë euro dhe tha se shpreson që gjatë

këtij viti të ecin mbarë procedurat e prokurimit, ashtu që ndërtimi të mund të fillojë sa më parë.

BERZh-i, BE-ja dhe Japonia përforcojnë investimet banesore për kursim të energjisë në Kosovë

Huaja prej 4 milionë eurosh për Banka për Biznes do t'u ndihmojë pronarëve të banesave dhe shtëpive të kursejnë energji

PRISHTINË, 14 MAJ - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po e shton mbështetjen e saj për financim të gjelbër me fonde të reja për Banka për Biznes në Kosovë.

Huaja e BERZh-it deri në 4 milionë euro në kuadër të Instrumentit për Financim të Ekonomisë së Gjelbër (GEFF) do t'i nxisë investimet për eficiencë të energjisë nga pronarët e banesave dhe shtëpive, kolektivat e banesave, prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve.

Projekti bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Japonia.

Kjo hua, e para për Banka për Biznes në kuadër të GEFF-it, do të mbështesë teknologji të gjelbra, materiale dhe zgjidhje me performancë të lartë për banesat dhe ndërtesat rezidenciale në pronësi private. Investimet në pajisje që kursejnë energji, siç janë izolimi, dritaret, pompat termike dhe panelet solare, do t'i ulin emetimet e gazrave serrë, do t'i ulin kostot e energjisë, si dhe do ta përmirësojnë cilësinë e jetës.

Përveç kredive, pronarët e banesave dhe të shtëpive do të përfitojnë pagesa stimuluese deri në 20 për qind të vlerës së kredisë pas instalimit të suksesshëm.

Banka për Biznes do të përfitojë asistencë teknike për të ndihmuar në krijimin e një modeli të ri financimi të përshtatur për kreditimin e gjelbër në sektorin e ndërtesave të banimit. Kjo mbështetje do t'u ofrohet edhe palëve më të gjera të interesit, siç janë kompanitë e ndërtimtarisë, shitësit dhe prodhuesit e teknologjive të gjelbra, në mënyrë që të avancohet tranzicioni i gjelbër në sektorin e banimit në tërësi.

Huaja lehtëson qasjen e Bankës për Tranzicionin e Ekonomisë së Gjelbër dhe do të mbështetet nga Fondi i Bashkëpunimit Japoni-BERZh dhe BE-ja nëpërmjet Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF).

Udhëheqësi i BERZh-it për Kosovën, Sergiy Maslichenko, u shpreh se janë krenarë që po vazhdojnë tranzicionin e energjisë së gjelbër në Kosovë



duke financuar përmirësimet e eficiencës së energjisë në ndërtesat e banimit, të cilat janë konsumatorët më të mëdha të energjisë në vend. "Përveç përfitimeve për të ardhmen e qëndrueshme të gjelbër të Kosovës, ky projekt sjell përfitime të drejtpërdrejta për familjet e Kosovës. Duke sjellë kursime në faturat e energjisë dhe duke rritur komoditetin shtëpiak, këto investime do t'ua bëjnë më të lehtë jetën pronarëve të banesave dhe shtëpive", ka theksuar ai.

Mimoza Godanci, kryeshefe ekzekutive e Bankës për Biznes, ka theksuar se po e nisin këtë rrugëtim drejt një ardhmërie më të qëndrueshme për Kosovën. "Ky partneritet me BERZh-in, BE-në dhe Japoninë përfaqëson një moment historik të

rëndësishëm për ne. Ky bashkëpunim nënvizon përkushtimin tonë për nxitjen e iniciativave të gjelbra që kontribuojnë në qëndrueshmërinë afatgjatë të mjedisit tonë dhe mirëqenien e familjeve kosovare. Jemi të nderuar që jemi pjesë e kësaj përpjekje transformuese dhe presim me padurim ndikimin pozitiv që do të ketë në shtetin tonë. Kjo iniciativë përputhet me vizionin strategjik të BpB-së për të ardhmen, duke reflektuar detyrën tonë si ndaj mjedisit ashtu edhe ndaj bizneseve që bëhen partnerët tanë", ka pohuar Godanci.

Banka për Biznes është bankë universale në Kosovë dhe klient afatgjatë i BERZh-it që zotëron 10 për qind të aksioneve të BpB-së.

Programi GEFF i BERZh-it u ka ndihmuar më shumë se 18 000 pronarëve të shtëpive dhe banesave në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe 1 700 amvisërive në Kosovë për ta përmirësuar eficiencën e tyre të energjisë.

Ky program mbështetet nga BE-ja dhe donatorë dypalësh, të cilët po sigurojnë fonde përmes WBIF si pjesë e Programit Rajonal për Eficiencë të Energjisë (REEP).

Projekti përputhet me prioritetet strategjike të BERZh-it në Kosovë: promovimi i ekonomisë së gjelbër, mbështetja e zhvillimit konkurrues të sektorit privat dhe nxitja e integritit rajonal.

Deri më sot BERZh-i ka investuar mbi 660 milionë euro në Kosovë përmes 108 projekteve.

BQK-ja: 2.5 milionë monedha nga 2 euro janë tërhequr nga qarkullimi

PRISHTINË, 14 MAJ - Banka Qendrore e Kosovës ka raportuar për suksesin e aktiviteteve të koordinuara për luftimin e monedhave të falsifikuara, veçanërisht monedhave 2 euro gjatë fundit të vitit 2023 dhe pjesës së parë të vitit 2024.

BQK-ja ka organizuar takime ndërinstitucionale për këtë qëllim dhe ka zhvilluar aktivitete në përputhje me Planin për Zbatim të Lehtësuar të Rregullores për Operacione me Para të Gatshme.

Në periudhën deri në prill 2024, BQK-ja ka arritur disa rezultate të rëndësishme në luftën kundër parave të falsifikuara dhe zbatimin e masave të rregullores për operacione me para të gatshme: Janë tërhequr nga qarkullimi dhe deponuar në BQK rreth 2.5 milionë copë monedha të denominimeve prej 2 eurosh; janë detektuar dhe u



është parandaluar hyrja në sistemin financiar rreth 54 000 copë monedha të denominimeve prej 2 eurosh,

duke i tërhequr nga qarkullimi të dyshuara si të falsifikuara; është furnizuar ekonomia me afër 7.4 milionë copë monedha euro

plotësisht të reja të të gjitha denominimeve pa asnjë tarifë të aplikuar; është furnizuar ekonomia me afër 5.82 milionë

copë kartëmonedha euro plotësisht të reja dhe të përshtatshme për riqarkullim në shumë prej 261.6 milionë eurosh; janë importuar monedha krejtësisht të reja 5 milionë copë, ose 8 milionë euro; janë eksportuar 2.4 milionë copë (2.8 milionë euro) të monedhës 2 euro (të tërhequra nga qarkullimi); numri i kartëmonedhave prej 500 (pesëqind) eurosh të tërhequra nga qarkullimi dhe deponuara në BQK ka kaluar mbi 266 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) copë/njësi në vlerë mbi 133 (njëqind e tridhjetë e tre) milionë euro; janë licencuar katër (4) banka për import/eksport të parasë së gatshme; dhe 57 autorizime (kryesisht të valutave jo-euro) për transport të parave të gatshme në kundërvlerë të tërësishme prej 177.4 milionë eurosh.

Poezia më e vjetër e dashurisë



Pllaka e vogël e baltës e njohur si “Istanbul 2461”, e cila ruhet në Muzeun Arkeologjik të Stambollit, përmban poezinë më të vjetër të dashurisë të njohur në botë. E shkruar në gjuhën sumeriane midis viteve 2037 dhe 2029 para Krishtit, kjo poezi është gdhendur në formën kuneiforme dhe është thesar i njerëzimit që ka mbijetuar deri në ditët e sotme.

Pllaka u zbulua në vitin 1889 gjatë gërmimeve në qytetin antik sumerian të Nipurit në Irakun juglindor. U përkthye në anglisht në vitin 1951 nga sumerologu amerikan Samuel Noah Kramer, i cili ka thënë:

Pllaka e vogël me numrin 2461, rrinte shtrirë në një nga sirtarët, rrethuar nga një sërë pjesësh të tjera. Kur ia hodha sytë për herë të parë, tipari më tërheqës i tij ishte se si ishte ruajtur. Shpejt kuptova se po e lexoja një poezi, të ndarë në një sërë strofash, që shënonin bukurinë dhe dashurinë, një nuse të hareshme dhe një mbret me emrin Shu-Sin ... Kur e lexova përsëri dhe përsëri, nuk mund të gaboja për përmbajtjen e saj. Ajo që mbaja në dorë ishte një nga këngët më të vjetra të dashurisë të shkruara nga dora e njeriut.

Shu-Sini, i emëruar sipas Sinit, zotit të Hënës – duke u nderuar si “hyjnor” – ishte mbret i sumerëve dhe akadëve, ndërsa sundoi rreth viteve 2038-2028 para Krishtit.

Megjithëse autorësia e saktë e poezisë nuk dihet, besohet të jetë poezi dashurie e shkruar nga një murgeshë e mbretit Shu-Sin. Në poezi, murgesha flet për bukurinë dhe sharmin e mbretit, duke shprehur dashurinë dhe admirimin e saj për të. Në të njëjtën kohë, ajo shpreh qartë dëshirën e saj për të qenë me mbretin.

Poezia përmban këto vargje:

*Dhëndër, i dashuri im,
E madhe është bukuria jote, e ëmbël si mjalti,
Luan, i dashuri im,
E madhe është bukuria jote, e ëmbël si mjalti.*

Më ke pushtuar, më lër të qëndroj duke u dridhur para teje.

*Dhëndër, ti do të më çosh në dhomën e gjumit,
Më ke pushtuar, më lër të qëndroj duke u dridhur para teje.*

Luan, ti do të më çosh në dhomën e gjumit.

*Dhëndër, më lër të të përkëdhel,
Përkëdhelja ime e butë është më e shijshme se mjalti,
Në dhomën e gjumit, të mbushur me mjaltë,
Më lër të shijoj bukurinë tënde të madhe,
Luan, më lër të të përkëdhel,
Përkëdhelja ime e butë është më e shijshme se mjalti.*

*Dhëndër, më ke kënaqur,
Tregoi nënës sime, ajo do të të japë ushqime të shijshme,
Babai im do të të japë dhuratat.*

*Shpirtin tënd, unë di ku ta ngazëllej shpirtin tënd,
Dhëndër, fli në shtëpinë tonë deri në agim,
Zemrën tënde, unë di ku ta ngazëllej zemrën tënde,
Luan, fli në shtëpinë tonë deri në agim.*

*Ti, meqë më do,
M'i jep të lutem përkëdheljet e tua,
Zoti im i mirë, Zoti im mbrojtës,
Shu-Sini im, që gëzon zemrën e Enlilit,
M'i jep të lutem përkëdheljet e tua.
Shtëpia jote është e mirë si mjalti, të lutem vëre dorën mbi të,
Afroje dorën si një rrobë gishbani,
Bashkoi duart mbi të si një rrobë gishbani*

Besohet se poezia është skenar për “martesën e shenjtë” vjetore, rit në të cilin mbreti në mënyrë simbolike martohet me perëndeshën Inana, bashkohet me të dhe siguron pjellorinë dhe prosperitetin për vitin e ardhshëm. Një priftëreshë ndoshta e përfaqësonte Inanën, perëndeshën sumere të pjellorisë, dhe mbreti Shu-Sin përfaqësonte Dumuzin, perëndinë e barinjve në prag të bashkimit të tyre.

Kramer ka shkruar:

Një herë në vit, sipas besimit sumerian, ishte detyrë e shenjtë e sundimtarit që të martohej me një priftëreshë dhe ithtare të Inanës, perëndeshës së dashurisë dhe pjellorisë, në mënyrë që të siguronte pjellorinë e tokës dhe pjellorinë në mitër. Ceremonia e nderuar festohej në ditën e Vitit të Ri dhe paraprihej nga gostitë dhe banketet e shoqëruara me muzikë, këngë e valle. Poezia e gdhendur në pllakën e vogël prej balte të Stambollit, sipas të gjitha gjasave është recituar nga nusja e zgjedhur e mbretit Shu-Sin në një prej këtyre manifestimeve të Vitit të Ri.

Studiuesi Jeremy Black, i njohur për punën që me tekstet mesopotamiane, e interpreton poemën në të njëjtën mënyrë:

Kjo është një nga disa këngët e dashurisë të krijuara për këtë mbret, që shfaq besimin në marrëdhënien e tij shumë të ngushtë dhe personale me perëndeshën e dashurisë. Në disa këngë të këtij lloji, emri i mbretit duket se është zëvendësuar thjesht me atë të Dumuzit [dashnori qiellor i Inanës në mit]. Pothuajse me siguri ato janë kryer në kontekstin e disa ritualeve fetare të cilat janë referuar si “martesa e shenjtë”, por detajet e sakta nuk dihen. Besimi se mbreti në njëfarë kuptimi mund të kryente marrëdhënie seksuale me perëndeshën, lidhet ngushtë me besimin se mbretërit e asaj kohe ishin hyjnorë.

Variantet e poemës mund të jenë kënduar gjatë ceremonive rituale që përkujtojnë martesën hyjnore midis dy perëndive në të gjithë Lindjen e Afërt të lashtë, veçanërisht në Egjipt. Përkthimi i kësaj pllake hedh dritë mbi Këngën e Solomonit në Dhiatën e Vjetër, sepse disa fraza janë të ngjashme me poezitë e kënduara gjatë festave të tilla të pjellorisë, si dhe në dasmat sumere.

“Istanbul 2461” ka rëndësi të madhe jo vetëm për vlerën historike dhe letrare, por edhe për historinë e njerëzimit. Kjo pllakë tregon se dashuria është emocion universal dhe se është shprehur në të njëjtën mënyrë mijëra vjet më parë. Gjithashtu ofron informacion të rëndësishëm për njohjen e letërsisë dhe artit sumerian. Përgatiti: *Telegrafi.com*

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Pensionohen Ergon Hyseni dhe Behar Bardhi

FERIZAJ, 14 MAJ - Kjo fundjavë kaloi me festë dhe momente gëzimi e krenarie në qytetin e Ferizajt. Padyshim se në kujtesën e qytetarëve do të mbeten dy lojtarë që u përshëndetën nga futbollit aktiv. Ergon Hyseni kundër KF Vushtrrisë e zhvilloi ndeshjen e tij të fundit, duke

i dhënë fund një karriere të pasur dhe me shumë suksese. “Mbreti i ajrit”, siç njihet në komunitetin sportiv, një jetë të tërë sportive ia kushtoi pothuajse FC Ferizajt, duke filluar nga kategoritë e reja të Shkollës së Futbollit “FC Ferizaj”, e duke e përfunduar në një

momentum të rëndësishëm rikthimin në Superligë. Edhe mbrojtësi tjetër, Behar Bardhi, këtë fundjavë u përshëndet nga futbollit aktiv, mes duartrokitjeve të tifozëve. Bardhi, një lojtar e mbi të gjitha individ me vlera të larta njerëzore, për shumë vite ka kontribuar për

klubin e Ferizajt, duke qenë shtyllë e fortë e mbrojtjes. Ai asnjëherë nuk është larguar nga dëshira për ta ngritur FC Ferizajn në nivele të larta, duke dhënë më të mirën nga vetja për suksesin e klubit. “Shëndet e shumë suksese Ergon Hyseni e Behar Bardhi! Do të mbeteni



përjetësisht pjesë e familjes së madhe të FC Ferizaj”, thuhet në postimin e Ferizajt.

Fetahu dhe Dushku, pjesëmarrës në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Evropës

PRISHTINË, 14 MAJ - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, kanë marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Evropës. Asambleja e Përgjithshme e FIBA Evropës është mbajtur më 11 maj në Portoroz të Sllovenisë. Asamblenë e Përgjithshme e ka kryesuar presidenti i FIBA Europës, Jorge Garbajosa, ku ishin të pranishëm edhe presidenti i FIBA-s, Sheikh Saud Ali Al Thani, sekretari i përgjithshëm i FIBA-s, Andreas Zagklis, drejtori ekzekutiv i FIBA-s për Evropë, Kamil Novak dhe anëtarët e Bordit të FIBA Europe, ku është edhe kryetari i FBK-së. Matjaz Han, ministri sloven për Ekonominë, Turizmin dhe Sportin, u uroi mirëseardhje delegatëve dhe shprehu krenarinë e tij, që organizimi po mbahet në Slloveni, një vend i apasionuar pas sportit, veçanërisht basketbollit. Garbajosa u kushtoi vëmendje të

veçantë përpjekjeve të FIBA Europe për të sjellë ide dhe inovacione të reja në basketboll si për garat e klubeve ashtu edhe ato kombëtare, duke i dhënë ende prioritet programeve bazë dhe zhvillimit. Në fjalimin e tij, sekretari i përgjithshëm i FIBA-s, Zagklis, u ndal në pozicionin e lojës së basketbollit të Evropës në hartën e basketbollit botëror. Ai mori si shembull organizimin e Botërorit të vitit të kaluar. Ai, gjithashtu, përsëriti rëndësinë e strategjisë së FIBA-s dhe tri shtyllave të saj - Fuqizimi i Federatave Kombëtare, Gratë në Basketboll dhe Formimi i Garave Ndërkombëtare të Klubeve - dhe synimet e zhvillimit të basketbollit të rinjve; duke e bërë 3x3 sportin urban më emocionues; arritjen e përvojës në organizimin e garave të ekipeve kombëtare; qëndrueshmërinë dhe inovacionin. Një sërë ndryshimesh në aktet nënligjore të FIBA Europe u miratuan nga



Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme e FIBA Europe 2025 do të mbahet në Letoni, ndërsa sesioni i vitit 2026 do të organizohet nga Federata e Basketbollit të Islandës në Reykjavik. Më 10 maj Dushku ka marrë pjesë në takimin e sekretarëve të përgjithshëm të federatave anëtare të FIBA

Europes që, po ashtu, u zhvillua në Slloveni, ku është diskutuar për tema të rëndësishme në basketbollin ndërkombëtar. Mbledhja e katër të Bordit të FIBA Europe, me mandat 2023-2027, është mbajtur të premten në Portoroz të Sllovenisë, ku mori pjesë edhe Fetahu. Gjatë takimit u diskutuan tema të rëndësishme si

EuroLiga e Femrave 2024-25, Garat e Klubeve 2023-24, Garat e Ekipeve Kombëtare, si dhe Bordi miratoi datat për raundin e dytë Parakualifikues të Kupës Botërore të Basketbollit FIBA 2027 në gusht 2025 (2, 6, 9, 13, 16 dhe 20 gusht). Mbledhja e radhës e Bordit do të mbahet në Stamboll, Turqi, më 28 nëntor 2024.

Thaqi dhe Dellova kërkohen nga CFR Cluj



CLUJ-NAPOCA, 14 MAJ - Dan Petresku po përgatit transferimet e para te CFR Cluj. Trajneri që shkroi historinë në Gruia është gati të luftojë sërish për titullin, pasi CFR Cluj u parakalua nga Farul Constanța dhe FCSB në dy sezonet e fundit. Për ta arritur objektivin e tij sezonin e ardhshëm, titullin dhe aksesin në grupet e Ligës së Konferencës së UEFA-s, Dan Petresku do të duhet ta rindërtojë skuadrën e tij dhe tashmë po përgatit lëvizjet e

para. Pasi u përfol se objektivi i parë do të ishte Aurelian Chițu (33 vjeç) nga FCU Craiova, Petresku tani ka kthyer vëmendjen te kampioni i Kosovës, Ballkani. Mbrojtësi i djathtë Armend Thaqi (31 vjeç) dhe qendërmbrojtësi Lumbardh Dellova (25 vjeç) janë objektivat e Dan Petreskut për periudhën e ardhshme të merkatos, raporton mediumi rumun “Sport”. Në CFR Cluj, Dan Petresku shtoi katër tituj kampionë në CV-në e tij;

2017/18, 2018/19, 2019/2020 dhe 2021/22. Në sezonin e fundit, gusht 2021 - qershor 2023, ai bëri 103 paraqitje në stol dhe mori një mesatare prej 1.81 pikësh për lojë, sipas statistikave të ofruara nga faqja e specializuar e internetit Transfermarkt. CFR Cluj është në vendin e dytë në Superligën rumune, me 43 pikë pas fitores me FCSB në fazën e fundit (1-0), dhe me shanse të rëndësishme për të rrëmbyer një vend në kupat e Evropës.

Dënohen Ylli dhe Trepça nga Komisioni i Garave i FBK-së

PRISHTINË, 14 MAJ - Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës të hënën mori vendimet lidhur me ndeshjen e dytë të serisë finale të “play-off”-it mes Golden Eagle Yllit dhe Trepçës, e cila u mbyll me fitoren

e vendasve 80:79. Pak para fundit të ndeshjes, Alonzo Verge Jr i Yllit dhe Kevin Capers i Trepçës kishin një përplasje dhe u diskualifikuan. Ata e vazhduan përplasjen rrugës për në zhvështore dhe kjo solli tensione

të tjera në palestër. Për gabimet diskualifikuese, Verge Jr e Capers janë gjobitur me nga 300 euro. Po ashtu, Ylli u gjobit me 200 euro, ndërsa trajneri i Yllit, Petar Mijoviq, me 300 euro. 300 euro është gjoba edhe për trajnerin e

Trepçës, Adis Beqiragiq. Erjon Kastrati është dënuar me 100 euro, ndërsa Trepça me 100 euro. Ndeshja e tretë finale zhvillohet të enjten me fillim nga ora 19:00 në Mitrovicë, teksa seria finale është bars 1:1.



Zhegrova: I lumtur që isha i nominuar për lojtarin më të mirë në Francë

PARIS, 14 MAJ - Kylian Mbappe është shpallur të hënën lojtari më i mirë në kampionatin francez të futbollit, Liga 1. Në mesin e të nominuarve për këtë çmim ishte edhe futbollisti i Kosovës, Edon Zhegrova. Me skuadrën e tij, Lille, Zhegrova këtë edicion

pati paraqitje fantastike. 25-vjeçari këtë edicion i ka realizuar gjashtë gola dhe ka bërë pesë asistime duke e ndihmuar skuadrën e tij të renditet në vendin e tretë me 58 pikë kur ka mbetur vetëm edhe një ndeshje për të përfunduar sezoni.

Me këtë rast, Edon Zhegrova i ka falënderuar të gjithë për mbështetjen që mori, ndërsa është shprehur i lumtur që ishte në mesin e të nominuarve për këtë çmim. "Shumë i lumtur që isha i nominuar për lojtarin më të mirë në Francë. Faleminderit

të gjithëve për mbështetjen që më keni dhënë gjatë gjithë sezonit! Le ta përfundojmë kampionatin me fitore të dielën", ka shkruar ai në Instagram. Zhegrova me paraqitjet e tij ka zgjuar interesim të madh nga disa skuadra të ndryshme



evropiane, duke përfshirë Romën dhe Juventusin.

Mbappe: Do të largohem nga PSG-ja

PARIS, 14 MAJ - Kylian Mbappe u shpall lojtari më i mirë në Ligën 1 për herë të pestë dhe, sapo doli në skenë për ta marrë çmimin, foli kështu për lamtumirën e tij të afërt me PSG-në: "Është e vështirë, shumë më tepër sesa mund të duket. Është një kapitull në jetën time që do të mbyllet. Në Paris kam luajtur me lojtarë të jashtëzakonshëm. Trajneri ka pasur gjithmonë besim tek unë, ashtu si stafi mjekësor, të gjithë njerëzit e klubit, drejtuesit sportivë dhe presidenti, lartësia e tij, Emiri, që erdhi për të më marrë në moshën 18-vjeçare dhe për të vënë bast për mua. Jam këtu për të falënderuar dhe shlyer besimin që më është dhënë në kohët e mira dhe të këqija, para se të largohesha. Faleminderit të gjithëve! Ka qenë një rrugëtim i gjatë dhe jam shumë i lumtur".



jam mundur në çdo moment ta nderoj Francën dhe të jem përfaqësues i denjë i Ligës 1. Do të më mungojë skuadra, klubi, por po largohem nga PSG me kokën lart. Babai im kërkonte që të bëja histori në Ligën 1 para se të largohesha nga kampionati francez. Për mua ishte një udhëtim i gjatë në këtë kampionat. Ndihej i lumtur për gjithçka kam arritur.

A do të merrni pjesë në Lojërat Olimpikë?

Mbappe: Të gjithë e dinë situatën, nuk është një vendim që varet nga unë. Çfarëdo që të ndodhë, unë do të jem i lumtur. Lojërat Olimpikë shkojnë përtej pranisë sime ose jo. Shpresoj që të tregojmë se Franca është një vend sporti dhe se dimë si ta mirëpres botën. Nuk do të jem kurrë larg nga këtu me zemër.

Kur do ta shpallni klubin tuaj të ardhshëm?

Mbappe: Në jetë duhet të merrni kohë për gjithçka. E vetmja gjë që duhet të dini është se unë po largohem nga PSG-ja. Pjesa tjetër ndoshta nuk është koha për ta zbuluar.

Çfarë mbani mend më shumë?

Mbappe: Shiko, të gjithë hapat që arrita të bëja në Paris. Gjithmonë kam shikuar përpara. Kur dëshiron të jesh ai që dua të jem, ka gjithmonë diçka përpara. Kur merr disa sekonda për ta parë, i thua vetes se ka qenë një rrugëtim i mrekullueshëm. Kam qenë në kontakt me lojtarë unikë. Kam pasur ndikim në kampionatin tonë. Nuk jam i befashuar më me asgjë. Për mua ishte kënaqësi e madhe të luaja në një vend unik, për një klub unik. Më vjen mirë që

Çfarë ndieni në prag të lamtumirës?

Mbappe: Një emocion të madh, sepse mendoj për gjithçka që kam kaluar, nga 'Clairefontaine' në Monaco. Do të largohem nga vendi im, do të nis një jetë të re si burrë. Jam thjesht një djalë 25-vjeçar, që e falënderoj Ligën 1. Kam pasur gjithmonë përshtypjen se jam i dashuruar. Kjo është një ndjenjë e këndshme.

Bostoni më pranë finaleve në Lindje, Oklahoma dhe Dallasi në ekuilibër në Perëndim

BOSTON, 14 MAJ - Bostoni u afrohet finaleve "play-off" në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 109-102 arritur në fushën e Clevelandit. Skuadra e Celticsit tashmë udhëheq 3-1 serinë e gjysmëfinaleve "play-off". Sfidë me rivalitet deri në fund, ku dyshja Tatum - Brown realizoi 60 pikë për Bostonin. Në kahun tjetër, për Clevelandin u dallua Garlandi me 30 pikë, por që nuk mjaftuan për ta fituar ndeshjen.



Në Konferencën e Perëndimit, ekuilibër në përballjen mes

Oklahomas e Dallasit. Sfidat u fituan me shifrat 100-96 nga Oklahoma, që barazoi 2-2 serinë, në një fitore të vështirë jashtë fushe. Alexander Shai me 34 pikë ishte lider për skuadrën mike, ndërsa për teksanët zhgënjyen lojtarët-liderë, duke humbur një shans të mirë për t'iu afruar finaleve "play-off".

KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

New York - Indiana (2-2)

Boston - Cleveland 109-102 (3-1)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Denver - Minnesota (2-2)

Oklahoma - Dallas 100-96 (2-2)

Trajneri i Spanjës: Në Evropian shkojmë për ta fituar

Trajneri i Spanjës, Luis de la Fuente, është shumë i qartë sa i takon objektivit të iberikasve në këtë edicion të Evropianit, aty ku bëjnë pjesë në Grupin B së bashku me Italinë, Kroacinë dhe

Shqipërinë. Në një intervistë për "Teledeporte", 62-vjeçari theksoi se "Furia e Kuqe" do të luajë me objektivin për të triumfuar. "Spanja ka fatin që në organikë të ketë shumë futbollistë të mirë.

Vendimin për lojtarët e grumbulluar do ta marrë pak më vonë. Por, i di të gjitha alternativat. Isco po bën shumë mirë, e meriton dhe ka mundësi që të jetë pjesë e kombëtares.

Unë shoh një Spanjë shumë të fortë për Evropianin, jam një 'gladiator' dhe nuk futem në luftë nëse nuk mendoj se do ta fitoj atë. Ne do të luftojmë fort për ta fituar Evropianin", u

shpreh De La Fuente. Spanja do të luajë ndaj Shqipërisë ndeshjen e tretë të grupit më 24 qershor në orën 21:00 në stadiumin Merkur Spiel - Arena të Dyseldorfit.

SHKURT

Varane konfirmon largimin nga Unitedi

Raphael Varane ka konfirmuar se do të largohet nga Manchester Unitedi në verë pas skadimit të kontratës së tij, pas tre sezoneve në "Old Trafford". Gjatë kohës së tij në "Old Trafford" i ka ardhur fundi dhe është vetë mbrojtësi francez që ka njoftuar largimin me anë të një video në profilin privat. "Për ju djema, mbështetës të Manchester Unitedit. Kanë qenë disa vite të mahnitshme për të luajtur për këtë klub të veçantë dhe duke veshur atë fanellë. Hera e parë që shkova në 'Old Trafford' si lojtar i Unitedit ishte diçka e çmendur. Atmosfera ishte e mahnitshme. U dashurova me klubin dhe tifozët. Duhet të luash për Man Utd për të kuptuar se çfarë përfaqëson. Për fëmijët e mi, këtu është shtëpia. Do të jetë një vend i veçantë për mua, për jetën. Kur tifozët shkojnë në 'Wembley', është diçka që ata e mbajnë mend gjatë gjithë jetës. Të ndaja atë moment me ta ishte absolutisht e mahnitshme", ka shkruar Varane. "Pavarësisht faktit se kemi pasur një sezon të vështirë, unë jam shumë pozitiv për të ardhmen. Pronarët e rinj po vijnë me një plan të qartë dhe një strategji të shkëlqyer. Do të shihemi në 'Old Trafford' për të thënë lamtumirë për ndeshjen e fundit në shtëpi këtë sezon dhe sigurisht që do të jetë një ditë shumë emocionale për mua", ka shtuar Varane.

Luis Diaz refuzon PSG-në: Jam shumë i lumtur te Liverpooli

Luiz Diaz ka refuzuar interesimin e Paris Saint-Germainit dhe ka vendosur të qëndrojë te Liverpooli, duke u shprehur se vite të mëdha do të vijë. Kolumbiani është në "Anfield" që prej janarit të 2022-s dhe ka një kontratë me Liverpoolin deri në vitin 2027, por thashethemet për një largim kanë qenë gjithnjë për Luiz Diazin. "Parisienët" do të futen në merkato për një sulmues të majtë këtë verë, pas largimit të Kylian Mbappes, mirëpo nga shumë specialistë të merkatos fjalët e fundit të Diazit janë kuptuar si një sinjal që ai është i lumtur te 19 herë kampionët e Anglisë. "Jam rritur shumë. Nga fillimi i karrierës dhe deri më sot. Përvoja te Liverpooli më ka ndihmuar shumë. E vërteta është se jam shumë i lumtur këtu. Vite të mëdha na presim në këtë skuadër. Nuk kam asnjë dyshim", u shpreh Luiz Diaz, i cili në 96 ndeshje për Liverpoolin ka shënuar 24 gola dhe ka dhuruar 13 asistime.

Fernandes mund të transferohet në Arabinë Saudite

Bruno Fernandes mund të largohet nga Manchester Unitedi këtë verë. Ai luan prej më shumë se katër vitesh me "Djajtë e Kuq", me të cilët ka një kontratë deri në vitin 2026. Humbjet e fundit në kampionat, një sezon zhgënjyes për të dhe Unitedin, duket se kanë ndikuar në mëdyshjen e portugezit për të vijuar në "Old Trafford". Këtë sezon ai ka mbajtur edhe shiritin e kapitenit. Sipas "The Sun", lojtari ka shfaqur disa pakënaqësi, ndaj dhe lamtumira mund të vijë më shpejt nga sa mendohej. Kjo ka sjellë interesimin e klubeve arabe për 29-vjeçarin, që kushton rreth 70 milionë euro. Duket se Fernandes i ka kërkuar klubit kohë të reflektojë, duke vendosur për të ardhmen pas "Euro 2024".


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 15.03.2024 për shpalljen e konkursit , gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 15.05.2024 të rishpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

Dy (2) Vozitës të kategorisë " C " - Njësia në Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Numri i referencës: 15-03-14

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtinë e tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikas dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit;
- Para daljes në teren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencën punët e kryera , vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njëjtën e kthen te dispeçeri;
- Vendos (monton) letren e re të tahogرافit ndërsa letren paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letren e tahogرافit ka obligim që në të shenon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopapat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon.largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhërësën e punës;
- Në rast nevojë ndron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmon me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Çdo sjellje të pandërgjegjshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi drejtpërdrejt;
- Kryepunëtori e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jasht planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër , dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, të drejtpërdrejt nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrje.

Kualifikimet

- Të ketë diplomën e shkollës mesme
- Vozitës i kategorisë "C"
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat, etj. mund të dorëzohen në Zyren e Arkivës në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 15.05.2024 deri më datën 29.05.2024. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" SH.A PEJË

NR 701

DATA 14.05.24

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë me datë 14.05.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : 2 Pozita VOZITËS-/ 1 AUTOMJETEVE PËR BARTJEN E HEDHURINAVE

Vendi punës Klinë:

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Paga Bruto 525.80 euro , plusë shujtja 88 euro Bruto

Ka këto detyra dhe përgjegjësi

- Drejton automjetin, kujdeset për rregullësin e tij dhe është përgjegjës për vozitjen e sigurt, duke i respektuar rregullat e komunikacionit.
- Kujdeset për higjienën dhe pastërtinë e automjetit, pas kryerjes së punës bënë larjen e automjetit.
- Çdo ditë merr urdhërësën e punës nga Kryepunëtori në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve
- Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatën për filxën zjarrit dhe paisjet përcjellëse të domosdoshme në komunikacion.
- Me rastin e prishjes së automjetit vozitësi është i obliguar të bënë ndreqje të vogla, si nderimin e gomës, pastrimin e filterit etj. të qëndroj pran automjetit në punëtorinë dhe të ndihmoimekanikut ose gomistit.
- Çdo mëngjez është i obliguar të kontrolloi sasinë e vajit, ujit dhe gjendjen e gomave në makinë.
- Është i obliguar që për prishjet në automjet me kohë të lajmëroi kryepunëtorin e vet drejtpërdrejt.
- Në rast të prishjes së automjetit me të cilin punon është i obliguar që të drejton automjet tjetër dhe kryen edhe punë tjera me urdhërës të Kryepunëtorit apo Menaxherit të Operatives.
- Është i obliguar te menaxhoi dhe të mbaj nen kontrole ekipin e punetoreve fizik.
- Kryen edhe punë tjera me urdhërës të Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives
- Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejt Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives, Kyeshfeft Ekzekutiv

a.Kushtet e përgjithshme :

- Një CV te detajuar
- Çertifikata që kandidati nuk është nen hetime
- Letër motivimi
- Kopja e leternjoftimit
- Çertifiata mbi gjendjen shendetore(kërkohet pas pranimit në punë)

b.Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Shkollimin e mesem
- Përgaditje profesionale-voztësi kategorive përkatëse
- Përparesi përvojë pune e deshmuar.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë
- dhe integritet të nivelit të lartë;

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 15.05.2024 deri me 30.05.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

**Thirrja për aplikim
(DHËNJE TË OFERTËS)**

“NERXHIVANE HAZIRI”B.I. me Numer Unik.Biz: 810790354 me seli Magjistralla Podujeve p.n. Komuna Podujevë me pronare NERXHIVANE HAZIRI , po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për mallrat/punët/shërbime këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre **Makinerve dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:**

- Makine per mbjelljen e perimeve, patateve, demsan 2 rendore PD2 super automatike ,
- Makine profesionale per nxjerren e karrotave, patateve unia me shirit transportues dhe per selektim,
- Rimorkio (per shperndarje te plehut organik) 5 ton
- Pllug Rrotullues 3 rendor Alpler,
- Pirunier Elektrik (minimum 1.5 ton)
- Kosha per Karrota - 100 cope (druri)
- Energji Solare 3.5 kw.

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek “NERXHIVANE HAZIRI”B.I. NERXHIVANE HAZIRI (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorezimit të Ofertave 10 ditë nga data e pranimit te ftesave per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: Magjistralla Podujeve p.n. Komuna Podujevë

Për Informata Shtesë tel: +383 44 170 417 dhe në email adresën:

fuadhazziri@gmail.com


Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “7 Woman Wings” SH.P.K. me seli në Skenderaj, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812057637 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “7 Woman Wings” D.O.O. Skenderaj, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812057637 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “7 Woman Wings” L.L.C. with headquarters Skenderaj, has come to the decision to quit its business: 812057637 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Oriflame Cosmetics” L.L.C. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810523937 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Oriflame Cosmetics” L.L.C. Prishtine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810523937 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Oriflame Cosmetics” L.L.C. Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810523937 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Durim Neziri shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit “Dardania” 03/09.
- Yll Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të .SH.M.E. “Kadri Kusari”.
- Habib Shehu nga Rahoveci shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu-ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

